

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"SEA SHALA" SHPK**

Sot me daten 26/11/2024 (dymijë e njëzet e katër ), unë ortaku themelues :

- **I Z. Sokol Shala** , shtetas shqiptar, i datëlindjes 05 Nentor 1980, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. ID I01105125G. Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ", Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar* " SEA SHALA " SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " SEA SHALA " SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në : Fugon Mercedes Benz me targe AA269LL me Nr Shasie WDB9036721R653111 Lagjja nr 18, Rruga Hysen Kertusha, Sheshi i Stadiumit Niko Dovana, zona kadastrale 8513.

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Transport udhëtarësh , femijesh, punetoresh, turistësh brenda dhe jashtë vendit.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë " SEA SHALA " SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

- 1. Sokol Shala zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.



**NENI 6**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Sokol Shala, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 7**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**  
**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Fushe Kruje për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**  
**"SEA SHALA" SH.P.K**



SOKOL SHALA

Sokol Shala

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of a large, looped initial 'S' followed by a few strokes.A smaller, stylized handwritten signature in blue ink, similar in style to the one above, located in the bottom right corner of the page.